

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Pa diskutim që qytetarët shqiptarë, sidomos ata që banojnë në qarkun e Korçës, prej kohësh kanë pritur, thuajse 10 vjet, që rruga Qukës-Qafë Plloçë të përfundojë dhe të jetë e aksesueshme. U bënë 9 vjet që për këtë projekt, i cili ishte lënë i gatshëm, me financim të gatshëm, Partia Socialiste dhe qeveria e PS-së nuk ka bërë asgjë, duke e lënë të gjithë zonën me një orë minimalisht vonesë. Të mos harrojmë se investimet e qeverisë së PD-së për qarkun e Korçës apo që i shërbejnë qarkut të Korçës kanë qenë të mëdha, si: tuneli i Elbasanit, rruga Korçë-Pogradec, rruga Lin-Pogradec, rruga Korçë-Kapshticë, po ashtu edhe rruga Korçë-Ersekë, që është ende e papërfunduar, pa diskutim është edhe unaza e qytetit, si dhe dhjetëra investime të tjera, që e kanë ndihmuar zonën.

PS-ja për të vetmen rrugë që iu la e gatshme, që është rruga Qukës-Qafë Plloçë, edhe sot del e thotë që do të bëhet vitin tjetër. E kemi dëgjuar katër herë ministren të thotë, sot zëvendëskryeministre, se përfundon pas gjashtë muajsh. Muajt ikin, por e vetmja gjë që ndodh këtu është se kjo qeveri e ka bërë rrugë që të vjedhë me rrugët. Pra, janë miliona euro që shpërdorohen vetëm për llogari të PS-së. Janë miliona lekë dhe miliona euro që po kthehen në miliarda, një hajdutëri brutale e një qeverisjeje, e cila interes të vetëm ka vjedhjen, pasurimin dhe të gjithë pronësimin e Shqipërisë për ta çuar në pesë njerëz. Kjo po ndodh sot në Shqipëri. Shikoni se si protestuan sot jashtë qytetarët e zonës së Bërçullës për projektin që prek zonën e tyre.

Pra, nga Kashari në Thumanë apo Thumana në Kashar do të bëhet një projekt që kushton 1,3 miliardë euro. Dëgjoni se çfarë po bëjnë me rrugët, e keni bërë rrugë duke vjedhur me rrugët. Për rrugën Lekaj-Fier jepni 350 milionë euro gjasme për një rrugë fushore, që shkon shumë më pak se investimi, ndërkohë do t'u zhvatni qytetarët shqiptarë 1,2 miliardë euro të tjera nga xhepat për t'ua dhënë kompanive oligarkike, për të cilat keni kaluar edhe ligje speciale. E njëjta gjë po ndodh edhe me Rrugën e Arbrit, nga 300 milionë, një rrugë e tenderuar në fillim me 70 milionë euro, e çuat 320 tani, ndërsa për skarpatet e kësaj rruge i jepni kompanisë edhe 20 milionë dollarë apo euro të tjera. Të njëjtën gjë po bëni edhe me rrugën Qukës-Qafë Plloçë, duke dhënë dhjetëra miliona euro të tjera.

Të gjitha këto nuk janë rastësi që bëhen përpara zgjedhjeve lokale; nuk është rastësi që i përqendroni të gjitha në 5 njerëz. Shihni projektin tjetër, atë të portit të Durrësit. Po u merrni një pasuri publike jo

vetëm qytetarëve shqiptarë, por të gjithë shqipfolësve në të gjitha trevat shqiptare, dhe ia jepni një kompanie për të përfituar, siç po u jepni kontratat, këtë e di i madh e i vogël, ndërtuesve. Jua vodhët edhe detin qytetarëve për të pastruar paratë tuaja në këtë projekt. Nuk ndalon fitimi dhe shpërdorimi i parave publike vetëm këtu, por keni gati edhe projektin tjetër, pra paratë që fitoni me portin e Durrësit pa diskutim i çoni në Porto Romano, tek oligarkë afër jush (këtu do të jemi do t'jua përmend të gjitha projektet me emër, qindarkë më qindarkë), për të fituar miliarda euro të tjera.

Këto janë operacione tipike mafioze, për ta përqendruar Shqipërinë në 5 duar oligarkësh, me të cilët ndani pasuritë, kontrolloni Shqipërinë, i trajtoni qytetarët shqiptarë si skllëvër. Në çdo hapësirë, në media, në parlament, në shoqëri civile, kushdo që ju del kundër mendoni se është armik, të cilit duhet t'i turreni, sepse mendoni se keni kapur qiellin me dorë. Por, siç ju ndodhi sot në Divjakë, që një grusht njerëzish, një grumbull njerëzish ju hodhën atje ku meritoni, ashtu kanë për t'ju hedhur edhe qytetarët, në koshin e plehrave, siç e meritoni, nëse vazhdoni me këtë histori. Kjo ka për të ndodhur shumë më shpejt seç e mendoni.

E keni kthyer Shqipërinë dhe po tentoni ta ktheni Shqipërinë, edhe nëpërmjet këtij parlamenti, që noterizon dhe ngre vetëm duart ndaj gjithçkaje sjell qeveria, në pronën e 5 njerëzve, të cilët do t'i them me emër herën tjetër. Prandaj sot nuk ka rritje pensionesh, rritje pagash për pedagogët që protestojnë, nuk ka rritje të ndihmës ekonomike për qytetarët, nuk ka pagesa për studentët, nuk ka mundësi për fëmijët, jo se nuk ka para, para ka, por paratë i shpërdorini duke i çuar në duart e këtyre pesë njerëzve. Shqetësimi i kësaj qeveri, i Edi Ramës, është të fryhet si kacak me paratë e qytetarëve shqiptarë, duke i marrë edhe gjakun e fundit çdo qytetari dhe duke e shpërdoruar për oligarkë, të cilët pa diskutim pjesën e më të madhe të parave e ndajnë me qeveritarët, duke filluar drejtpërdrejt nga Kryeministri.

Prandaj rriten taksat, prandaj rritet energjia, prandaj goditen profesionistët e lirë, jo vetëm si një mënyrë për t'ju vjelë para, por edhe si një taktikë për t'i përzënë qytetarët shqiptarë nga ky vend, për t'ua bërë jetesën të pamundur, duke u vendosur lloj-lloj birbosh dhe injorantësh, të cilët me kompanitë e krijuara marrin çdo para dhe pronë publike të këtij vendi. Në drejtim të institucioneve kryesore keni vendosur injorantët, keni vendosur njerëz që nuk dinë as Abetaren për të drejtuar punët e këtij shteti, gjë që e bën të pamundur jetesën për të gjithë qytetarët e tjerë që investojnë në shkollim, që investojnë për të ardhmen e fëmijëve të tyre, për të gjithë qytetarët që përpiqen të jetojnë me punë të ndershme në këtë vend.

Të njëjtën problematikë e keni në çdo fushë të vendit. Shikoni sesi ulet çmimi i naftës në bursë çdo ditë dhe të gjitha vendet e tjera e ulin, ndërsa në Shqipëri as nuk mblidhet bordi i oligarkëve, por edhe kur mblidhet e ul çmimin me dy lekë, sa për t'u tallur. Janë miliona euro që qarkullojnë dhe futen në xhepat e oligarkëve dhe të qeveritarëve nëpërmjet naftës, dhe nuk është vetëm kjo skemë nëpërmjet bordit të oligarkëve, është edhe skema tjetër, për të cilën edhe sot nuk jepni dot përgjigje, tre anije për 1 muaj, me evazion më shumë 13-14 milionë dollarë, që vijnë nga një vend nën embargo si Libia, shkarkohen në Shqipëri, për të cilat nuk ka sot asnjë të arrestuar apo të proceduar shqiptar, përveç disa arabëve dhe disa libianëve, të cilët i kapën në det pas sinjalizimit që dhanë partnerët ndërkombëtarë.

Sinjalizimi i vetëm që ka bërë shteti shqiptar dhe policia shqiptare ka qenë sinjalizimi që u ka bërë kontrabandistëve shqiptarë që të mos shkojë operacioni deri në fund dhe ata të arrestohen, ashtu siç e meritojnë. Këto nuk i bëjnë dot njerëz që shesin naftë me bidonë, por i bëjnë këta që kanë mundësi t'i kalojnë në porte, që kanë mundësi t'i kalojnë në dhjetëra pika shpërndarjeje, që kanë mundësi të shmangin agjencitë doganore, të shmangin të gjitha detyrimet, të shmangin të gjitha agjencitë qeveritare, duke kaluar miliona euro drejtpërdrejt në xhepat e qeveritarëve. Të njëjtën politikë ndiqni dhe ndjek kjo qeveri edhe në raport me ndërtimet dhe me çdo gjë tjetër, ku i barabarti para ligjit nuk ekziston, barazia para ligjit nuk ekziston, ata që janë më të fortë bëjnë ligjin, ata që janë më të dobët ligji u bie mbi kurriz.

A e patë së fundi, pas këngëtarit Lako, sesi e dënuan një poete me ashpërsinë më të madhe të ligjit për ndërtimet që bëri për riparimet e shtëpisë, që i ishte prishur nga tërmeti? Shikoni pak rreth e rrotull, sapo del nga ky parlament, sa kulla pa leje janë, për të cilat edhe sot e kësaj dite nuk kanë guxim të kthejnë përgjigje as drejtoresha e IKMT-së, as ministri i Brendshëm, as Kryeministri, që e kam lajmëruar me shkresë? Si ka mundësi që dhjetëra pallate pa leje, në mes të Tiranës, në zonat më të lakmueshme, 100 metra larg Ministrisë së Brendshme, shumë pak metra larg çdo institucioni në këtë vend, e kanë kthyer Tiranën jo vetëm lavatriçe të pastrimit të parave të pista, por edhe një nga vendet ku po ndërtohet në mënyrë të paligjshme, për të cilat as nuk ka të arrestuar nga këta oligarkë, as ka të proceduar, as nuk ju prishen banesat, as nuk ju prishen ndërtimit që dua të shesin, por bëhen ligje speciale për t'i amnistuar qoftë me VKM, qoftë duke përdorur KKT-në, Kryeministrin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për të legalizuar miliona euro para të këtyre njerëzve, që po e ndajnë Shqipërinë si plaçkë?

Për këto arsye do ta mbyll aty ku e nisa, për të vazhduar pastaj te ligji për vetingun e policisë, tek injorantët e tjerë, siç ju ndodhi sot, edhe duke tejkualuar opozitën, nëse doni ju, edhe duke tejkualuar

banorët e Bërxullit, të cilët protestonin dhe nuk pritën që të ishim ne atje, siç protestuar sot qytetarët e Divjakës, kështu të gjithë qytetarët e Shqipërisë kanë për t'ju marrë para dhe pas diskutim edhe ne duhet të jemi në lartësinë e detyrës. Faleminderit!